



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR ____ DATË ____ / ____ / 2025

PËR

**MIRATIMIN E NJË SHTESE NË PIKËN NR. 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT
BASHKIAK NR. 66 DATË 25.06.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË
ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT
TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË
TERRITORIN E BASHKISË Durrës”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 89/2022, datë 22.12.2022 “Për policinë bashkiake”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.194 datë 22.12.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e bashkisë Durrës”, shkresës nr.10322 prot., datë 01.09.2025 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, shkresës nr.10322/1 prot., datë 02.09.2025 nga Drejtoria Ligjore si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e një shtese në pikën nr. 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66 datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e bashkisë Durrës”, duke shtuar pas nënpikës 7, nënpikën 8 me emërtimin:

8. Sheshi “26 Nentori 1912”, pranë Stacionit të Trenit, Durrës

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore


Alneida Rroshi



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIK

Drejtore

Ardian Hjazaj



KRYETAR

Emiriana Sako



BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË PIKËN 2 TË
VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.66 DATË 25.06.2024 'PËR
PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE
TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE
SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës'**

Baza ligjore: Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), Ligji nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligji Nr. 89/2022, datë 22.12.2022 "Për policinë bashkiake", VKM Nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", si dhe Udhëzimit Nr. 7, datë 10.06.2008 "Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë", VKB Nr. 113 dt 24.12.2024 'Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2025', shkresa Nr.10322 prot datë 01.09.2025 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, shkresës Nr.10322/1 prot..datë 02.09.2025 nga Drejtoria Ligjore, Bashkia Durrës dhe me propozim të titullarit të Institucionit,

Të nderuar këshilltarë,

Ju paraqesim sa më poshtë vijon:

Me VKB nr. 66 datë 25.06.2024 'Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës', në pikën 2, janë të miratuara sheshet e destinuara për parkim me pagesë sipas listës së mëposhtme:

1. Sheshi prane Bar Portofino.
2. Sheshet në rrugën "Mars 91" Durrës (dy sheshe).
3. Sheshi ndodhur poshtë Urës së Dajlanit.
4. Sheshi "Jorgji Ziu" tek Mauzoleumi i Dëshmorëve.
5. Sheshi në territorin e brendshëm të Pallatit të Sportit "Ramazan Njala".
6. Sheshi pranë tregut industrial, në rrugën "Hysen Myshketa"
7. Sheshi Vollga pranë Autoritetit Portual Durrës.

me qëllim mbulimin e plotë të nevojave të qytetit për vendparkime, për një shërbim sa më efikas në fushën e transportit dhe mbështetur në shkresën Nr.10322 prot datë 01.09.2025 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, shkresën Nr.10322/1 prot..datë 02.09.2025 nga Drejtoria Ligjore mbi konfirmimin e gjendjes juridike të pronësisë të vendndodhjes: 'Sheshi 26 Nentori 1912', përpara Stacionit të Trenit, Durrës, propozojmë që në listen e shesheve të destinuara për parkim me pagese të miratuara me VKB 66/25.06.2024, në pikën 2 të shtohet :

- Sheshi '26 Nentori 1912', përpara Stacionit Të Trenit, Durrës

Sqarojmë se , bazuar në konfirmimin e gjendjes juridike të pronësisë të këtij sheshi ,ardhur me shkresën sa më lart cituar nga Drejtoria Ligjore, figuron se sheshi në fjalë me Nr.Pasurie 4/2 , ZK 8514, është në pronësi 'Shtet'.

Sheshi '26 Nentori 1912', sipas VKB nr.202, datë 24.02.2010 "Për miratimin e zonave të destinuara për parkim në qytetin e Durrësit, në të cilat qëndrimi i mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një shume që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit", ka qënë e miratuar si zonë e destinuar për parkim.

Sa më sipër, jemi të mendimit për miratimin e një shtese në pikën 2 të VKB nr. 66 datë 25.06.2024 'Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës', ku konkretisht në listen e shesheve të destinuara për parkim me pagese të miratuara me këtë vendim keshilli bashkiak në pikën 2 të shtohet dhe sheshi si më poshtë , sipas hartës bashkëlidhur:

- Sheshi "26 Nentori 1912", përpara Stacionit Të Trenit, Durrës.

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR

Ardian Iljazaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8514

KODI UNIK: 8514010058

NUMRI PASURISË: 4/2

INDEKSI HARTËS: DR; J-6

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI
Elvis Pengili

Data e lëshimit 9/2/2025

SHPJEGUES

- ☐ PARCELA
☒ NDËRTESA